



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN**  
**E TË DHËNAVE PERSONALE**  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr.3120/1 prot.

Tiranë më 17.12.2025

Lënda: Mendim mbi një projektvendim

**MINISTRISË SË ARSIMIT**

**Tiranë**

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj me nr. 7013/5 prot., datë 02.12.2025, protokolluar me tonën me nr. 3120 prot., datë 04.12.2025, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektvendimin “Për miratimin e Kodit të Etikës në Shkencë dhe në Kërkim Shkencor” së bashku me relacionin shoqërues.

Nga shqyrtimi i projektvendimit dhe materialeve përkatëse konstatohet se ky dokument synon vendosjen e parimeve, standardeve dhe rregullave etike për zhvillimin e veprimtarive kërkimore dhe shkencore në institucionet kërkimore dhe institucionet e arsimit të lartë.

Në këtë kuadër, vlerësojmë me rëndësi të theksohet se çdo përpunim dhe ndërveprim me të dhëna personale gjatë veprimtarisë së kërkimit shkencor duhet të sigurojë përputhshmëri të plotë me parashikimet e ligjit nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Më konkretisht, lidhur me përmbajtjen e nenit 11 të Kodit propozojmë që të plotësohet dhe të riformulohet sipas nenit me këtë përmbajtje:

**Neni 11**

***Mbrojtja e të dhënave personale***

1. Përpunimi i të dhënave personale për qëllime kërkimore ose shkencore kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Institucionet kërkimore dhe të arsimit të lartë që kryejnë veprimtari kërkimore shkencore sigurojnë parimin e minimizimit të të dhënave personale, duke mbledhur vetëm të dhënat që janë të nevojshme për qëllimet e kërkimit shkencor.
3. Të dhënat personale të mbledhura gjatë veprimtarisë kërkimore shkencore, anonimizohen ose pseudonimizohen në mënyrë të tillë që të përmbushet qëllimi i përpunimit. Institucionet kërkimore dhe institucionet e arsimit të lartë përcaktojnë

*procedura të qarta anonimizimi, pseudonimizimi, fshirje ose ruajtjen e të dhënave për aq kohë sa është e nevojshme për realizimin e qëllimit të përpunimit.*

4. *Institucionet kërkimore dhe të arsimit të lartë gjatë veprimtarisë kërkimore shkencore marrin masat e duhura teknike dhe organizative për të siguruar një nivel sigurie të përshtatshëm ndaj rrezikut, për çdo veprim lidhur me aksesin, ndryshimin, korrigjimin, përhapjen e të dhënave personale, me qëllim garantimin gjurmueshmërisë, konfidencialitetit, integritetit, disponueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e përpunimit të të dhënave personale.*

Në përfundim, me përfshirjen e sugjerimeve të mësipërme Zyra e Komisionerit shprehet dakord me përmbajtjen e projektvendimit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**